

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE  
" XHAFERRAJ -ALUMIN " SH.P.K. (ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)**

1. **Xhevair Xhaferraj** i biri i Nazif dhe Bejushe, lindur me 02.01.1967 ne Permet dhe banues ne lagjen nr. 8 rr " Lucie Bekerdheli" Durres, identifikuar me Karte Identiteti Nr.ID 029108733 dhe Nr.personal G701020521.
2. **Albert Latifi** i biri i Sadik dhe Asije, lindur me 16.04.1976 ne Gramsh dhe banues ne lgj nr. 2, rr. Sefer Efendiu", Durres, identifikuar me ane te Kartes se identitetit me Nr.ID 025300350 dhe Nr.H60416069M.
3. **Bejushe Xhaferraj** e bija e Shefit dhe Rubije, lindur me 02.09.1946 ne Tepelene dhe banuese ne lgj nr. 8 rr "Lucie Bekerdheli" Durres, identitetin e t ciles e njoha ne baze te Kartes se identitetit me Nr.ID 025300083 dhe Nr.personal E65902018N.

Ne personat e mesiperm te gjithe madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar dhe juridike, me deshire dhe vullnet te lire, si ortakje vendosem themelimin e nje shoqerie qe ploteson kushtet e kerkuara nga neni 3, 4, 6, 7, 8,9, e vijues te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare" si vijon:

**NENI 1  
Objekt i shoqerise**

Shoqeria " XHAFERRAJ -ALUMIN " sh.p.k do te kete si aktivitetet e saj:

1. Tregtim materiale ndertimi, alumini etj
2. Punime alumini, kangjella etj.
3. Import eksport
4. Tregtim materiale te ndryshme.

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqeria eshte quajtur " XHAFERRAJ -ALUMIN "shpk dhe eshte me pergjegjesi te kufizuar.

**NENI 3  
Qendra e shoqerise**

Qendra e shoqerise eshte ne Durres, lagj nr. 17, rr "Stef Kacalini", prane shkolles jo publike "Encida".

**NENI 4  
Legjislacioni kompetent**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj duke u bazuar ne legjislacionin shqiptar.

**NENI 5  
Kapitali shoqeror**

Kapitali i shoqerise ne themelimin e saj eshte 5.000.000 leke, kapital i cili eshte formuar me kontribut te perbashket te ortakjeve ne raportet 40% te kapitalit ne vleren 2.000.000(dymilion) leke eshte kontribut i Xhevair Xhaferraj, 40% e kapitalit ne



vleren 2.000.000(dy milion)leke eshte kontribut i Bejushe Xhaferraj dhe 20 % e kapitalit ne vleren 1.000.000 (nje milion)leke eshte kontribut i Albert Latifi.

**NENI 6**  
**Kohezgjatja e shoqerise.**

Eshte parashikuar qe kjo shoqeri te kete nje kohezgjatje te aktivitetit te saj me afat te pacaktuar .

**NENI 7**  
**Administratori dhe kohezgjatja**

Administrator i Shoqerise "XHAFERRAJ –ALUMIN" sh.p.k. do te jete **Albert Latifi** per nje afat 5-vjecar.

**NENI 8**  
**Fitimi**

Pas zbritjes nga te ardhurat, te te gjitha detyrimeve te ligjshme ndaj shtetit dhe ndaj personave fizike dhe juridike, fitimi i takon ortakeve te shoqerise ne raportet 40% te fitimit Z.Xhevair Xhaferraj, 40% te fitimit Bejushe Xhaferraj dhe 20% te fitimit Albert Latifi. Ne keto raporte do te perballohen dhe shpenzimet e shoqerise.

**NENI 9**  
**Hyrja ne fuqi**

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise prane QKR –se , konform ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit .

**ORTAKET THEMELUES**

**XHEVAIR XHAFERRAJ**

*Xhevair Xhaferraj*  
*Xh*

**BEJUSHE XHAFERRAJ**

*Bejushe Xhaferraj*  
*B.E.*

**ALBERT LATIFI**

*Albert Latifi*  
*A*

**STATUTI I SHOQERISE "XHAFERRAJ-ALUMIN" SHPK**  
**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "XHAFERRAJ-ALUMIN" sh.p.k krijohet nga ortakët e mëposhtëm, në bazë të ligjeve në fuqi të shtetit shqiptar me qëllim që të realizojë një aktivitet ekonomik të rregulluar nga ky statut.

**Ortakët:**

\* **Xhevair Xhaferraj** i biri i Nazif dhe Bejushë, lindur me 02.01.1967 në Permet dhe banues në lagjen nr. 8 rr "Lucie Bekerdheli" Durrës, identifikuar me Kartë Identiteti Nr.ID 029108733 dhe Nr.personal G701020521.

\* **Albert Latifi** i biri i Sadik dhe Asije, lindur me 16.04.1976 në Gramsh dhe banues në lgj nr. 2, rr. Sefer Efendiu", Durrës, identifikuar me anë të Kartës së identitetit me Nr.ID 025300350 dhe Nr.H60416069M.

\* **Bejushë Xhaferraj** e bija e Shefit dhe Rubije, lindur me 02.09.1946 në Tepelene dhe banuese në lgj nr. 8, Rr "Lucie Bekerdheli" Durrës, identitetin e të cilit e njohë në bazë të Kartës së identitetit me Nr.ID 025300083 dhe Nr.personal E65902018N.

Kreu I

**DISPOZITA TE PERGJITHSHE**

**NENI 1**

Shoqëria e krijuar është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e rregulluar nga ligji shqiptar me nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

Shoqëria është person juridik, personaliteti i të cilit krijohet nga dita e regjistrimit të saj në organet kompetente shtetërore, dhe konkretisht pranë QKR – se.

**NENI 2**

Shoqëria është emërtuar "XHAFERRAJ – ALUMIN" sh.p.k. Qendra e shoqërisë është në Durrës, lgj nr. 17, rr "Stef Kaculini", pranë shkollës jo publike "Eneida"

**NENI 3**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me mjetet e veta financiare dhe me burime të ligjshme financimi. Shoqëria do të vepronte sipas legjislacionit shqiptar, sipas rregullave të përcaktuara në aktin e themelimit dhe në këtë statut.

Kreu II

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**NENI 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- 1- Tregtim materiale ndërtimi, alumini etj
- 2- Punime alumini, kangjella etj.
- 3- Import eksport
- 4- Tregtim materiale të ndryshme

Keto aktivitetet shoqeria do t'i kryej duke bere edhe investimet e duhura te nevojshme per realizimin e aktiviteteve te saj. Ne te ardhmen objekti i shoqerise mund te zgjerohet edhe me aktivitetet tjera te lejuara nga ligji.

Kreu III  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**  
**NENI 5**

Shoqeria e fillon aktivitetin e saj me marrjen e lejes nga organet kompetente, dhe me rregjistrimin e saj ne baze te neneve 26, 28, 32, 35 te ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " prane QKR - se.

**NENI 6**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar, afat qe fillon nga dita e rregjistrimit te saj.

Kreu IV  
**KAPITALI I SHOQERISE**

**NENI 7**

Kapitali i shoqerise ne themelimin e saj eshte 5.000.000 leke.  
Kapitali themeltar perbehet nga kuota ne vlefte leku te cilat i takojne ne raportet prej 40% te kapitalit ne vleren 2.000.000leke eshte kontribut i Xhevair Xhaferraj, 40% e kapitalit ne vleren 2.000.000 leke eshte kontribut i Bejushe Xhaferraj dhe 20% e kapitalit ne vlere 1.000.000leke eshte kontribut i Albert Latifi.

Ortaket pergjigjen per humbje te shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

\* Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te ortakeve, por ai nuk mund te zbrese nen kufirin minimal prej 100 lekesh te caktuar nga ligji.

\* Percaktimi i pjeseve te kapitalit ne monedhe shqiptare ndaj asaj te huaj behet me kursin e kembimit ne ditën e lindjes se nevojës per kete percaktim.

\* Perverc kontributeve ne para, kontributi ne kapitalin e shoqerise mund te jete edhe ne natyre, te cilat vleresohen nga nje ekspert per kontributet se deri ne cilen mase do te jene.

\* Kuota e kapitalit te kesaj shoqerie do te zoterohet nga te tre ortakët , dhe si e tille te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo kuote do te jene ne raportet 40% Xhevair Xhaferraj, 20% Albert Latifi, 40% Bejushe Xhaferraj.

**NENI 8**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ne keto menyra:

\* Me sjelljen e drejtperdrejte nga ortakët e shoqerise ne kapitalin shoqeror me vendim unanim te tyre duke ruajtur raportet e caktuara me lart.

\* Me perdorimin e fitimit te pashpermdare me pare ose me perdorimin e fondeve rezerve.

\* Me çdo menyre tjeter te lejuar nga ligji.

**NENI 9**

Ortakët mund te vendosin qe nje pjese e fitimit te destinohet per rezerve per shoqerine si fond zhvillimi ose fond rezerve.

## NENI 10

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar tek personat e tretë nëpërmjet njerës nga menjrat e percaktuara me ligj mund të bëhet vetëm me miratimin e ortakëve, pra të shoqërisë, ose të drejtën e parashlyes në favor të shoqërisë apo ortakut tjetër.

Transferimi i kapitalit themeltar nga njëri ortak tek tjetri është lirisht i transferueshem.

## Kreu V ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 11 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe gëzon të gjithë të drejtat e caktuara nga ligji. Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë si më poshtë :

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- Ndryshimi i Statutit
- Miratimi i programit vjetor të shoqërisë, inventareve dhe llogarive vjetore.
- Asambleja ka të drejtën e shqyrtimit të raportit të Ekspertit kontabel dhe çdo ortak duhet të vihet në dijeni 15 dite përpara nga eksperti për raportin e përgatitur prej tij .
- Miratimi i strukture, krijimi i organeve të ndryshme të shoqërisë, degeve, agjensive, përfaqësive si dhe mbyllja e veprimtarisë së tyre.
- Pranimi i ortakëve të rinj.
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë.
- Miratimi i likuidimit të shoqërisë.
- Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve me vendim të ortakëve .
- Emerimi dhe shkarkimi i një ose më shumë eksperteve kontabel të autorizuar për shoqërinë duke respektuar dispozitat ligjore të ligjit
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedime të tjera administrative
- Rirrganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- Miratimi i shitblerjes së pasurive të shoqërisë.
- Përcaktimi i përputhshmërisë së investimeve të nevojshme me zhvillimin strukturor të shoqërisë.
- Përfitim nga rezultatet, përcaktimi i përqindjes së rezervës së kapitalit për zhvillim, fond rezerve etj.
- Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e asamblese dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron.
- Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
- Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme duhet të regjistrohen në një regjister, në të kundërt janë të pavlefshme.
- Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara në ligj dhe në statut.

### NENI 12 ADMINISTRATORI

Administratori i shoqërisë "XHAFERRAJ-ALUMIN "sh.p.k. është Z. Albert Latifi për një afat 5-vjeçar.

Administratori duhet të veprojë brenda objektit të shoqërisë.

Me miratimin e tre ortakëve, mund të pranohen edhe persona të tjerë si ortakë, mbas shqyrtimit të kërkesës me shkrim nga personi i interesuar, ku pranon të gjitha normat

e caktuara nga statuti.

Edhe pas pranimit të ortakeve të tjera, administrator do të jetë ai që është caktuar me këtë statut.

Administratori emerohet dhe shkarkohet vetëm me vendim të asamblese së ortakeve. Administratori ka fuqi ligjore të kryeje të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë, duke respektuar ligjet në fuqi.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji jua jep shprehimisht asamblese së ortakeve.

Administratori i Shoqërisë është Perfaqësuesi ligjor i saj për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

Veprimet e kryera nga Administratori janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse ato tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të perfaqësimit që i jep ligji.

Pasojat e marrëveshjeve të nënshkruara nga administrator ose ortakut, për të cilat nuk është marrë me parë miratimi nga asambleja, dhe që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit ose ortakut që ka lidhur këto marrëveshje pa miratim të asamblese. Dëmi i sjellë shoqërisë duhet të perballojë individualisht ose nëse janë me tepër se një duhet të perballojë solidarisht.

### NENI 13

Për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike si dhe të problemeve të tjera, administratori mund të autorizojë persona të caktuar si dhe të caktojë specialiste të ndryshëm për procese specifike, në funksion të veprimtarisë së kesaj shoqërie duke i ngarkuar me detyra konkrete.

Për kryerjen e aktivitetit të saj, shoqëria mund të punësojë persona të tjerë jashtë shoqërisë për kryerjen e punimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me objektin e kesaj shoqërie ose për zgjidhjen e problemeve të vecanta.

Struktura e brendshme, numri dhe specialiteti i punonjësve caktohet nga administratori në një Rregullore të Brendshme të shoqërisë.

Marrëdhëniet e punës në shoqëri do të rregullohen sipas legjislacionit të punës duke lidhur kontratat përkatëse.

### Kreu VI

#### AKTIVITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR I SHOQËRISE

### NENI 14

Detyrë dhe qëllim i shoqërisë dhe i ortakeve të saj është që me aktivitetin që do të kryejnë të mbulojnë shpenzimet dhe të realizojnë fitime.

### NENI 15

Për të plotësuar qëllimin e saj, shoqëria mund të kryej veprime si:

- Te hapë llogari pranë bankave si dhe institucioneve të tjera të kreditit.
- Te marrë hua nga institucione krediti ose të tjera si këto.
- Te lidhë kontrata e marrëveshje me institucione shtetërore dhe persona fizike apo juridike të tjera sipas ligjit dhe leverdisë ekonomike.
- Te hapë filiale, dege, agjensi, perfaqësi në rrethe të tjera të vendit.
- Te ketë pasuri të ndryshme, të luajtshme e të paluajtshme. Këto të fundit rregjistrohen në organet përkatëse në baze të rregullave të percaktuara me ligj.

### NENI 16

Burimet e veta të financimit dhe fitimit, shoqëria i përdor sipas vendimeve të asamblese, brenda kufijve të caktuar me ligj ose me dispozita të tjera.



#### NENI 17

Te ardhurave te realizuara nga aktiviteti i zbriten te gjitha detyrimet e ligjshme, si dhe tatimet e taksat qe percakton ligji.

Per veprimtarine e saj ekonomike, shoqeria mban bilanc te rregullt sipas rregullave te caktuara me ligj ose akte te tjera.

#### NENI 18

Viti financiar hapet me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

Brenda dates 15 Mars, administrator duhet te marre masa per hartimin e bilancit, ku evidentohen te ardhurat, shpenzimet dhe nxjerrja e rezultatit.

Rezultati i nxjerre i perket ne ortakeve sipas percaktimeve me lart te kuotave.

#### NENI 19

Humbjet qe rezultojne, do te mbulohen nga fondi rezerve dhe ne rast se ai eshte i pamjaftueshem.

Ortaket mund te vendosin per forma te tjera te mbulimit te humbjeve.

Kur nga humbjet e rezultuara, kapitali mbetet me pak se kufiri minimal i percaktuar ne ligj, brenda tre muajve ortaket duhet te vendosin per mbulimin e tyre dhe vijueshmerine e shoqerise. Ne rast te kundert cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates duke kerkuar prishjen dhe likuidimin e shoqerise.

### Kreu VII

## PUSHIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

#### NENI 20

Shoqeria pushon aktivitetin e saj:

- Kur perfundon afati i percaktuar ne statut.
- Me vendim te asamblese.
- Per shkak te pushimit te aktivitetit.
- Per shkak te shkrirjes dhe bashkimit ne shoqeri te tjera.
- Me falimentim
- Me vendim gjyqesor ne rastet e percaktuara ne ligj.
- Ne te gjitha rastet e tjera te lejuara nga ligji.

Ne vazhdim asambleja emerone nje ose me shume likuidatore. Ne rast te kundert, eshte gjykata ajo qe emerone likuidatoret dhe percakton perfundimin e likuidimit.

Me perfundimin e likuidimit, mbetja qe rezulton i takon ortakeve sipas pjeseve perkates ne kapitalin themeltar.

### Kreu IX

## DISPOZITA TE FUNDIT

#### NENI 21

Te gjitha punonjesit e shoqerise, sidomos ata me pergjegjesi, detyrohen te ruajne fshehtesine e dokumentacionit, te informacionit, te njohurive dhe te pervojës se realizuar ne kuadrin e aktivitetit te shoqerise dhe te marrin masat per te shmangur perhapjen e tyre.

Ata pergjigjen per pasojat e demshme te nje shkelje te ketij detyrimi, kur kjo shkelje eshte rrjedhim i ndonje veprimi te kryer me dashje ose nga pakujdesia.

#### NENI 22

Te gjitha problemet qe nuk jane trajtuar ne kete statut, do te zgjidhen sipas dispozitave perkatese ne fuqi ne kohen e lindjes se nevojës per zbatim.

**NENI 23**

Ky statut, si dhe dokumentat e tjera themeluese te kesaj shoqerie jane hartuar ne baze te ligjit nr. 9901 DT. 14.04.2008 Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

**NENI 24**

Ne rast te ndryshimeve te legjislacionit qe mund te sjellin si pasoje mosperputhjen e statutit me ligjin, statuti do te rishikohet dhe do te modifikohet.

**NENI 25**

Per gjithcka qe palet nuk shprehen ne kete statut palet do ti referohen Ligjit nr. 9901 DT. 14.04.2008 Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Kodit Civil dhe ligjeve te tjera ne fuqi te shtetit shqiptar.

**ORTAKET THEMELUES**

**XHEVAIR XHAFERRAJ**

*Xhevahir Xhaferraj*  
*Xh*

**BEJUSHE XHAFERRAJ**

*Bejushë Xhaferraj*  
*BEJ*

**ALBERT LATIFI**  
*Albert Latifi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
Nr 290 Rep, Nr 929/3 Kol

**VERTEIM**

Sot me date 27.11.2012(Dymije e dymbedhete), para Meje **Noterit Florian Hoxha** me zyre Noteriale prane Gjykates se rrethit Gjyqsor Durres, u paraqiten personalisht shtetasit e meposhtem dhe konkretisht:

\* **Xhevahir Xhaferraj** i biri i Nazif dhe Bejushë, lindur me 02.01.1967 ne Permet dhe banues ne lagjen nr. 8 rr “ Lucie Bekerdheli” Durres, identifikuar me Karte Identiteti Nr.ID 029108733 dhe Nr.personal G701020521.

\* **Albert Latifi** i biri i Sadik dhe Asije, lindur me 16.04.1976 ne Gramsh dhe banues ne lgj nr. 2. rr. Sefer Efendiu”, Durres, identifikuar me ane te Kartes se identitetit me Nr.ID 025300350 dhe Nr.H60416069M.

\* **Bejushë Xhaferraj** e bija e Shefit dhe Rubije, lindur me 02.09.1946 ne Tepelene dhe banuese ne lgj nr. 8, Rr “Lucie Bekerdheli” Durres, identitetin e t ciles e njoha ne baze te Kartes se identitetit me Nr.ID 025300083 dhe Nr.personal E65902018N.

Te cilet jane dakort me vullnetin e shprehur per sa me sipër me regjistrimin e ketij **Akt-Themelimi** dhe **STATUT te Shoqerise “Xhaferraj-Alumin” sh.p.k.**, nenshkraun parameje dhe Une Noteri vertetoj autenticitetin e nenskrimeve te tyre.....

Une Noteri Vertetoj



**NOTERI**  
**Florian HOXHA**  
*[Handwritten Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



mbajtës i kartës  
**Latifi**  
emri i plotë  
**Albert**  
emri i familjes  
**Shqiptare/Albanian**  
kombësia/çështja e kombit  
**Gramsh, Gramsh**  
qyteti/çështja e qytetit  
**16-04-1976**  
data e lindjes/çështja e datës  
**07-05-2009**  
data e miratimit të kartës  
**MB**



numri i identifikimit të shtetshqiptarëve  
**025300350**  
gjinia  
**M**  
data e skadencës së kartës  
**06-05-2019**  
numri i përshkrimit të kartës  
**H60416069M**